



## Sesion Informues

Komuna e Gjakovës fton të gjithë punëdhënësit nga rajoni i Gjakovës, Rahovecit, Deçanit, Malishevës në sesionin informues të Panairit të Punës 2019, i cili organizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), Komunën e Gjakovës dhe Zyrën Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).

Sesioni informues do të mbahet më datën **28.02.2019 (E enjte) në ora 11:00, në sallën e kuvendit komunal në Gjakovë.**

Sesioni informues organizohet në partneritet me *Zyrën e Punësimit Gjakovë, Qendra për Aftësim Profesional, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, Oda Ekonomike Regjionale, Qendra Rinore Gjakovë* dhe ka për qëllim të njoftojë dhe ofrojë udhëzime më të qarta për të gjithë punëdhënësit që janë të interesuar të marrin pjesë në panair. Gjithashtu, gjatë sesionit informues do të keni mundësi të regjistroheni përmes aplikimit online apo formularit për aplikim (kopje fizike).

**Për kompanitë/Organizatat** – Të gjithë punëkërkuessit të cilët shpallin vendet e lira të punës apo praktikës në punë, gjatë panairit mund të intervistojnë dhe vlerësojnë kandidatët potencial për punë apo praktikë në punë.

**Për punëkërkuessit** – Punëkërkuessit do të kenë mundësinë e aplikimit apo intervistimit të praktikës në punë apo vendeve të lira të cilat shpallen nga Kompanitë, si dhe informata për trajnime e aftësime profesionale.

Informacione të tjera shtesë për mundësitë për të përfitur nga programet:

- **Praktika në punë**, duke angazhuar praktikantë për 6 muaj (ku 4 muaj subvencionohen nga APRK/GIZ)
- **Trajnimi në vend të punës**, duke trajnuar punëtorët e rinjë për 3 muaj (ku 2 muaj subvencionohen nga APRK/GIZ).
- **Trajnimin e trajnerëve në kompaninë tuaj.**
- **Mbulimin e shpenzimeve të shtandit** i cili ka këto dimensione 2x2m dhe 2.5m lartësi, i cili përbëhet prej një tavoline informuese për vendosjen e materialeve, manualeve, broshurave dhe posterëve, një tavolinë (0.8x0.8m) me mbulesë të bardhë dhe dy ulëse ku mund të intervistoni punëkërkuessit e mundshëm.